

## **PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Mallra**

### **PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “Marrje me qira e dy automjeteve”**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP):45500000-2**

**VLERA E FONDIT LIMIT: 3,120,000** (Tre milion e njëqind e njëzet mijë) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), autoriteti/enti kontraktor **Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a.** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar.

### **KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

**2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

**2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2022-2023-2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Kriteri i pikës 2.2.1 është vendosur referuar nenit 43, pika 2/c të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku është përcaktuar qartë vlera e kërkuar për xhiron minimale vjetore, dhe pikës 3 të nenit 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe Rekomandimit të APP-së nr7998 date 24.12.2021. Vlera e kërkuar është brenda kufijve të vendosur në dispozitat më sipër, dhe është vendosur me qëllim që AK të sigurohet për potencialin ekonomiko-financiar të OE ofertues, që lidhet drejtëpërdrejtë me qëndrueshmërinë dhe vijimësinë e veprimtarisë së operatorëve ekonomikë në treg, si një element i rëndësishëm në realizimin e objektit të prokurimit dhe përmbushjes së detyrimeve kontraktore.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenit 43, pika 1, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. AK në vendosjen e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 61 të Ligjit nr.29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat" si dhe kërkesat e Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

## **2.3 Kapaciteti teknik:**

**2.3.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të madhe se 20 % të vlerës së fondit limit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 54, pika 4 b) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më të madhe se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në dispozitat e sipërcituara.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar është përcaktuar bazuar në legjislacionin e fushës, konkretisht, nenit 54, pika 4 b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, duke shërbyer kështu si një garanci për AK, që ofertuesit zotërojnë kapacitete dhe eksperiencë për të zbatuar kontratën, me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie dhe në përmbushje të specifikimeve teknike.

**2.3.2** Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur, në emrin e tij si subjekt, me certifikatë ISO 9001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”, ose ekuivalente / të barazvlefshme.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 4, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 40 dhe 44, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Për të realizuar shërbimin e mësipërm Autoriteti Kontraktues ka nevojë të bashkëpunojë me operatorë ekonomikë të cilët i ofrojnë siguri Autoriteti Kontraktues kërkon garanci nga ana e operatorit ekonomik gjë e cila vërtetohet me dokumentet e mësipërm.

Kërkesa për ISO 9001:2015 lind pasi ky certifikim është një standard i njohur globalisht për menaxhimin e cilësisë. Ai ndihmon në përmirësimin e cilësisë, që operatorët ekonomikë të përmbushin pritshmëritë e klientëve dhe të demonstrojnë përkushtimin e tyre ndaj cilësisë. Kjo kërkesë përcakton se si të krijohet, zbatohet, mirëmbahet dhe përmirësohet vazhdimisht një sistem i menaxhimit të cilësisë. Zbatimi i ISO 9001 do të thotë që operatori ka vendosur procese efektive dhe staf të trajnuar për të ofruar produkte ose shërbime të përsosura herë pas here. Standardi siguron që organizatat të kenë procese të fuqishme të kontrollit të cilësisë, duke çuar në rritjen e besimit dhe kënaqësisë së klientit.

**2.3.3** Operatori ekonomik duhet të deklarojë se do të pajisë mjetin me siguracion të detyrueshëm TPL, si edhe Siguracion i plotë KASKO (sipas ligjit përkatës) për gjithë periudhën e qirasë së plotë operacionale. Për këtë duhet të paraqesë një deklaratë që në momentin e shpalljes së fituesit sipas dokumentacionit të kërkuar më sipër dhe gjatë gjithë periudhës së qirasë ndjek të gjitha procedurat e nevojshme.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 4, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 40 dhe 44, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Për të realizuar shërbimin e mësipërm Autoriteti Kontraktues ka nevojë të bashkëpunojë me operatorë ekonomikë të cilët i ofrojnë siguri Autoriteti Kontraktues kërkon garanci nga ana e operatorit ekonomik gjë e cila vërtetohet me dokumentet e mësipërm, apo me deklaratën se operatori mund të realizojë shërbimin sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktues. Dokumentacioni i përmendur më sipër lidhet ngushtësisht me mjetin ndaj operatorit ekonomik si pronar i tij duhet të kryejë këtë procedurë për sigurimin e automjeteve.

**2.3.4** Operatori ekonomik duhet të mbulojë të gjitha detyrimet në lidhje me institucionet përkatëse ( taksa rrugore / qarkullimi të vitit përkatës / etj). Për përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me shkrim.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 4, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 40 dhe 44, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Duke qenë se Operatori ekonomik është pronari i automjeteve që vendos në dispozicion, të gjitha detyrimet që lidhen me automjetin janë pagesë e tij, ndaj operatorët ekonomikë duhet të mbulojnë të gjitha këto detyrime.

Kjo kërkesë lidhet ngushtësisht me mjetin dhe pronarin e tij, i cili përballon shpenzimet e dokumentacionit ligjor të automjetit, pagesa që janë vjetore apo periodike pa të cilat automjetit nuk do të qarkullonte lirshëm.

**2.3.5** Autorizim nga prodhuesi ose nga distributor i autorizuar nga prodhuesi për llojin e mjetit të ofruar. Autorizimi duhet të përmbaje të dhëna të plota të prodhuesit si: tel, fax, email, website, kjo e nevojshme për AK në rast verifikimi nga ana e tij.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 4, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 44, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Për të realizuar shërbimin e mësipërm Autoriteti Kontraktues ka nevojë të bashkëpunojë me operatorë ekonomikë të cilët i ofrojnë siguri Autoriteti Kontraktues kërkon garanci nga ana e operatorit ekonomik gjë e cila vërtetohet me dokumentet e mësipërme.

Kërkesa për dokumentacionin e pronësisë së automjeteve lind pasi Autoriteti Kontraktues, do të marrë me qira dhe do të përdorë këto automjete çdo ditë për afatin kohor të caktuar ndaj duhet të bëjë të gjitha verifikimet e nevojshme lidhur me dokumentacionin e pronësisë së automjetit.

**2.3.6** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalogun teknik, në të cilin të jenë të markuara në mënyrë të qartë dhe të dallueshme pjesët / fragmente që i përkasin të dhënave teknike të mjetit të ofruar në përputhje me specifikimet teknike.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 4, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 40 dhe 44, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Kjo kërkesë lind pasi automjetet duhet të përmbushin kriteret e vendosura nga Autoriteti Kontraktues, ky kriter siguron verifikueshmëri të saktë të përputhshmërisë së mjetit me specifikimet, lehtëson vlerësimin, garanton transparencë dhe trajtim të barabartë të ofertuesve dhe rrit përgjegjshmërinë e operatorit ekonomik për informacionin e paraqitur.

**2.3.7** Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë që ka servis të specializuar dhe garanton kryerjen e nevojave për mirëmbajtjen dhe riparimin e mjeteve, në servisin e tij / një servisi të marrë me qera, apo përmes një servisi me të cilin mund të ketë të lidhur një kontratë bashkëpunimi të vlefshme përgjatë kohës së realizimit të kontratës, dhe të specifikojë adresën e servisit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 4, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 40 dhe 44, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Kjo kërkesë lidhet me faktin që është operatori ekonomik ai i cili në rast defektesh të automjeteve duhet të kryejë riparimet e nevojshme. Operatori ekonomik në rast defekti të njërit prej mjeteveve, garanton vënien menjëherë në dispozicion të një mjeti zëvendësues deri në riparimin e tij, pasi automjeti qëndron në punë gjatë gjithë periudhës dhe një defekt i automjetit nuk duhet të ndalojë aktivitetin e autoritetit kontraktues për asnjë lloj arsye.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

***Në rast të ofertave nga ofertues të huaj, dokumentat e ofertës duhet të jenë ekuivalente me dokumentat e kërkuar sipas legjislacionit të fushës.***

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

Specifikimet teknike, termat e referencës dhe përlllogaritja e fondit limit janë përgatitur dhe hartuar nga Autoriteti Kontraktor “AGJENCIA PËR DIALOG DHE BASHKËQEVERISJE” për nevojat e së cilit, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara, në cilësinë e Organit Qendror Blerës kryen procedurën e prokurimit, në zbatim të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM-në nr.531 datë 7.9.2023 “Për krijimin e shoqërisë aksionare shtetërore “Operatori i Blerjeve të Përqëndruara” Sh.a për kryerjen e procedurave të veçanta të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, Ministrive dhe Institucioneve të Varësise”, i ndryshuar.

## **NJËSIA E PROKURIMIT**